



we: 12.10.2022.

MALI I ZI

we: 11.11.2022

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale

Në bazë të nenit 5 të Vendimit mbi kriteret për shpërndarjen e bursave në Komunë të Tuzit ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 032/21), Sekretariati për vetëqeverisje lokale shpall

## KONKURS

### Për ndarjen e bursave për vitin akademik 2022/2023

Komuna e Tuzit, shpërndan bursa për vitin akademik 2022/2023 për studentet e:

- studimeve universitare
- studimeve të specializuara dhe
- studimet master.

(bursa vlen për studentët brenda dhe jashtë vendit)

Të drejtën për bursë mund ta realizojnë studentët të cilët janë pa të dy prindërit, personat me invaliditet dhe komuniteti i popullatës RAE, pa marrë parasysh rezultatit e arritur në shkollimin paraprak. Të drejtën për bursë mund ta realizojnë edhe studentët të cilët studiojnë drejtimit deficitare me kusht që në vitin paraprak të studimeve të kenë arritur notën mesatare prej së paku 8,00, gjegjësisht, të jenë bartës të diplomës "Pishtarë" në shkollë të mesme.

Në bazë të të dhënave të dorëzuara nga Enti për punësim i Malit të Zi, profesionet deficitare janë si në vijim:

- Profesionet në fushën e informatikës dhe teknologjive informative (shkalla VII-të e kualifikimeve arsimore – **informaticient, programues i sistemit të informacionit**);
- Mësimdhënësit e shkencave natyrore dhe matematikës (shkalla e VII-të e kualifikimeve arsimore - **profesor i matematikës, profesor i fizikës, profesor i kimisë**);
- Inxhinieri elektrike (shkalla e VII e kualifikimit arsimor – **inxhinier i diplomuar në elektroteknikë për elektroteknikë, inxhinier i diplomuar në elektroteknikë për energji, inxhinier i diplomuar në inxhinieri elektrike për teknologji kompjuterike**);
- Ndërtimtari - **profesionet e arsimit të lartë - shkalla VII i kualifikimeve të arsimit**;

Si dhe disa profesione të tjera: profesionet në edukim dhe arsimim - (shkalla VII e kualifikimeve arsimore - **arsimi parashkollor - profesor, kujdestar i klasës, profesor në fushën e edukimit muzikor (grup lëndësh muzikore, piano, kitarë), profesor i gjuhës gjermane, profesor i biologjisë, profesor i grupeve të lëndëve të artit, pastaj defektolog, pedagog dhe psikolog (shkalla VII), mjekë specialistë (radiodiagnostikë, gjinekologji dhe obstetrikë, neurologji, pediatri, kirurgji e përgjithshme, anestezi me reanimim), inxhinier i diplomuar në gjeodezi, matematikan, inxhinier bujqësor i diplomuar për prodhim bimor.**

Të drejtë burse kanë studentët të cilët:

- notën mesatare më të ulët për të gjitha vitet e studimit e kanë 9, gjegjësisht 8 për profesionet deficitare,
- regjistrojnë për herë të parë semestrin e vitit studimor,
- gjatë studimeve të tyre nuk kanë humbur asnjë vit,
- kanë vendbanimin në komunën e Tuzit,

- janë shtetas të Malit të Zi,
- janë bartës të diplomës “Pishtarë”

Bursat jepen për një vit akademik dhe do të paguhen çdo muaj, për dhjetë muaj të vitit akademik.

Kandidatët që aplikojnë për bursa krahas fletëparaqitjes për konkurs dorëzojnë edhe dokumentet e mëposhtme:

- vërtetimin mbi notën mesatare totale për të gjitha vitet e studimit,
- vërtetimin e regjistrimit në vitin e studimit,
- vërtetimin mbi vendbanimin,
- vërtetimin mbi shtetësinë,
- dëshminë (deklaratën) se studenti nuk merr një bursë tjetër,
- dëshminë se ai/ajo është bartës i diplomës "Pishtarë".

Procedurën për ndarjen e bursave e zbaton Komisioni për ndarjen e bursave.

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve, Komisioni përcakton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit. Lista do të publikohet në faqen e internetit dhe tabelën e njoftimeve të komunës.

Një bursist humbet të drejtën e bursës nëse konstatohet se :

- vërtetohet se ai/ajo, të drejtën në bursë e ka realizuar në bazë të të dhënave të pasakta,
- ka ndryshuar vendbanimin,
- ka ndërprerë studimet,
- dhe në raste të tjera të përcaktuara me kontratë.

### **Afati për tu paraqitur në Konkurs është 30 ditë.**

Paraqitjet jo të plota ose jashtë afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Fletëparaqitja për Konkurs mund të merret në Arkiv ose ne faqen zyrtare të internetit të Komunës së Tuzit.

Dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, me mbishkrimin: “Konkurs për bursë”, në Arkivin e Komunës, ose të dërgohet përmes postës.

Të gjitha informacionet shtesë lidhur me Konkursin, mund të merren përmes numrit te telefonit: 020/875-167

**SEKRETARË**

